



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 4 Datë 24.12.2019

Për

Miratimin në lidhje me projektin për rehabilitimin e Digës së Okshtunit Rrogozhinë

Në zbatim të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, nenit 8 nenit 9 si dhe pika 4 e nenit 20 të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave” të miratuar me VKM nr. 147, datë 18.03.2004, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përherëshëm i Digave të Mëdha në mbledhjen e tij të datës 24.12.2019, mori në shqyrtim materialin e arrdhur nga Bashkia Rrogozhinë të plotësuar sipas rekomandimeve të kërkuar nga KKDM në lidhje me projektin për rehabilitimin e Digës së Okshtunit Rrogozhinë.

Rezervuari i Okshtunit është ndërtuar në vitin 1970 me volum uji 4,5 milion m³ me të cilin ujiten 2000 ha të fshatrave në luginën e përroit të Okshtunit. Diga është me gjatësi 450m dhe lartësi 30m trupi i digës është me mbushje dhera suargjilorë.

Në këtë digë ndër vite janë kryer ndërhyrje ndër të cilat më kryesore përmendim, betonimin e pjesëshme të pragut të shkarkuesit i cili është në kullën e ndërtuar për këtë qëllim, e cila shërben edhe si ujëlëshues. Po ashtu me kalimin e viteve ka patur dëmtime sic janë, deformimi i kurorës së digës, prishjes së parapetit, degradimi i veshjes me gurë në bjeftin e sipërm etj.

Për këtë doli e nevojshme që të kryhen ndërhyrje për rehabilitimin e Digës së Okshtunit Rrogozhinë.

Materiali u prezantua nga përfaqësuesit e shoqërisë Arabel Studio shpk dhe ing. Fari Maho.

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, duke mbajtur parasysh ndërhyrjet që janë bërë në digë, rëndësinë e saj si dhe dëmtimet e mungesën e mirëmbajtjes në kohë, mbas paraqitjes dhe diskutimeve:

VENDOSI

Të miratojë projektin për rehabilitimin e Digës së Okshtunit Rrogozhinë (kurorës së digës, parapetit beton-arme, shkarkuesit, etj) duke plotësuar sa vijon:

- Për sa i takon pragut kapërderdhës të shkarkuesit katastrofik, të shikohet zgjidhja me kapërderdhës në formë transheje (i vëndosur pothuajse tërthor me aksin e digës) mbasi është forma e shkarkuesit të zbatuar në shumicën e këtyre digave në vend dhe kanë rezultuar si një zgjidhje funksionale e mirë.
- Mbas zbrazjes së rezervuarit në verën e vitit 2020 duhet të kryhet dhe kontrolli i gjendjes së ujëlshuesit kryesor që kalon nga kulla në trupin e digës, i përshkruar në projekt me gjatësi 102m dhe përmasa 1,5x1.1m (beton-arme). Në bazë të kontrollit të merren masat e duhura për riparim.
Kjo kërkesë është e vlefshme dhe për portat, mekanizmin e ngritjes dhe kanalaturave të ndodhura në kullën beton arme.
- Bashkia Rogozhinë si pronar i digës duhet të marrë masat për monitorimin e digës duke plotësuar strukturat e njësisë së drejtimit teknik në zbatim të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” dhe VKM nr. 147, datë 18.03.2004 “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”
- Dokumentacioni për këtë digë të plotësohet me studimin për përhapjen e valës sipas kërkesave ligjore të digave/dambave dhe Udhëzimit 248 datë 28.01.2000 e firmosur nga gjashtë ministri. Ky studim të përfundojë e të miratohet brenda muajit qershor 2020.
- Zbatimi i kërkesave të mësipërme të dërgohen zyrtarisht në Sekretariatit Kombëtar të Digave të Mëdha dhe simbas kërkesave ligjore të bëhen dhe miratimet në KKDM.

Për/Maksim Mucin
K R Y E T A R

Fatos Hoxha

N/K R Y E T A R

